



Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF)



Të përgjithshme

Korça është një nga rajonet më të mëdha në Shqipëri ku prodhohet molla. Rreth 85% e prodhimit të përgjithshëm të mollës në Shqipëri është në Korçë dhe ndërkohe 10% e fermerëve përdorin teknologji moderne për prodhimin e mollëve (sistemi intensiv i kultivimit të mollëve) dhe kanë filluar me zbatimin e prodhimit të integruar të mollëve.



PRODHIMTARIA E MOLLËS NË VITE

Në Shqipëri janë të mbjellura rreth 14 milion rrënjë pemë frutore, ku peshën kryesore e zë molla. Molla kryesisht kultivohet në rajonin e Korcës dhe Dibrës. Sipërfaqja e tokës së kultivuar me mollë është rreth 4,500 ha me një prodhimtari në shkallë kombëtare rreth 105,000 ton mollë.

Varietetet kryesore që prodhohen në sasi të mëdha janë Golden Delicious, Granny Smith, Starking, Red Chief dhe një sasi e vogël janë të varieteteve Fuji, Gala etj. Sezoni i vjeljes së mollës fillon në fund të muajit shtator dhe përgatitjet për treg të brëndshëm, apo eksport fillojnë në fund të muajit tetor dhe vazhdojnë deri në shkurt-mars.

Aktualisht në Korçë kultivohen rreth 2.5 milion rrënjë mollë me një rendiment mesatar 32 ton/ha. Shërbimet agro-teknike fillojnë me krasitjen në muajin janar-shkurt, grirjen e degëve të krasitura, plehrimin organik dhe frezimin.

Në vazhdim në pemëtore kryhen spërkatjet në faza të ndryshme, që shkojnë nga 12-16 spërkatje, shoqëruar me plehrimet me kristalore, gjethore, fungicite etj. Rrallimi i frutave është gjithashtu një proces i rëndësishëm.

Ujitja fillon zakonisht në muajin maj dhe vazhdon deri në muajin shtator. Shpenzimet në një pemëtore me teknologji të lartë shkojnë deri në 1,300,000 lekë/ha.

Një nga problematikat e shfaqura në pemëtoret me mollë janë dëmtimet nga ngrica (muaji prill), apo edhe breshëri (qershor-gusht). Këto kanë ndikuar në të pasurit një rendiment 20% më të ulët dhe një rënie prej 20-30% në prodhimtari. Kosto për blerjen dhe instalimin e rrjetave antibreshër në 1ha pemëtore kushton rreth 25,000 euro.

CMIMET E TREGUT DHE IMPORTI I MOLLËS

Në shkallë kombëtare, në 3 vitet e fundit, prodhimtaria e mollës paraqitet me një rritje të lehtë si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe situata pandemike.

Vitet	Sipërfaqja/ha	Prodhimi/ton
2017	4346	96,338
2018	4294	108,375
2019	4407	105,933

> Në Qarkun e Korcës operojnë 71 frigoriferë ruajtës së mollës me një kapacitet rreth 20,000 ton, në Qarkun e Dibrës operojnë 4 frigoriferë ruajtës me një kapacitet 1200 ton, në Fushë - Krujë operon 1 frigorifer me kapacitet 1200 ton mollë.

> Cmimet e shitjes së mollës variojnë sipas varieteteve dhe cilësisë së tyre.

Cmimi i shitjes në fermë (Shtator-Tetor 2020)	
Varietetet e mollës	Cmimi (lek/kg)
Starking	45
Golden Delicious	45
Grand Smith	40
Idare	25
Fuji	70

> Situata e tregimit të mollës nga ambjentet frigoriferike është e ulët. Në krahasim me vitet e mëparshme rezulton një rënie e aksesit në tregje, me afërsisht 40% të sasisë së ruajtur. Gjithashtu edhe cmimet rezultojnë më të ulta, me rreth 20% më pak se vitet e mëparshme.

Cmimi i shitjes në frigorifer (Dhjetor-15 Janar 2021)	
Varietetet e mollës	Cmimi (lek/kg)
Starking	60
Golden Delicious	60
Grand Smith	55
Idare	25
Fuji	80

> Gjatë vitit 2020 janë importuar 8,211,325 kg mollë, afërsisht 10% më shumë se viti 2018 dhe 2019.

Të gjitha investimet e prezantuara mbështeten lehtësisht nga programi i granteve IPARD dhe fondi i garancisë së BERZH-it dhe Qeverisë Shqiptare-AASF. Financimi i investimeve mund të përfshihet nën programin AASF, duke i ofruar kështu mundësinë që investimet e planifikuara nga bizneset të përfitojnë nga kushtet lehtësuese që ofrohen nëpërmjet Institucioneve Financiare Partnere të programit. Institucionet Financiare Partnere të AASF janë: ProCredit Bank, IntesaSanpaolo Bank, OTP Bank, Raiffeisen Bank dhe Fondi Besa.



REKOMANDIME

- ✓ Zhvillimi i mëtejshëm i sektorit të mollës kërkon përmirësime në strukturën e kultivarëve, kapaciteteve të ruajtjes në kushte frigoriferike dhe industrisë së përpunimit të mollës.
- ✓ Mbjelljet e reja të pemëtoreve të mollëve, duke përfshirë këtu zëvendësimin e varieteteve më pak të preferuara, me varietetet që kërkohen më tepër nga tregu, duke përdorur teknologji shumë intensive - sipas tendencave të kohëve të fundit – e cila përbën një mundësi për investime.
- ✓ Pavarësisht rritjes së kapaciteteve të ruajtjes në kushte frigoriferike, identifikohen ende nevoja të rritjes së këtyre kapaciteteve duke aplikuar teknologji me standarte të larta, apo teknologji me atmosferë të kontrolluar. Qëndrat e grumbullimit shërbejnë edhe si përmirësues të standardeve, duke konsideruar këtu se tregjet e eksportit janë shumë konkurruese dhe kërkuese për sa i përket standardeve. Gjithashtu edhe linjat moderne të selektimit, pastrimit dhe ambalazhimit janë një domosdoshmëri për operatorët e këtij biznesi.
- ✓ Zhvillimi i industrisë përpunuese, operimi në treg i 2 fabrikave të prodhimit të lëngjeve (në Korcë dhe Dibër), sjell domosdoshmërinë e investimit në linja të përpunimit të mollës për prodhim koncentratit, i cili aktualisht vjen nga importi. Shqipëria mund të kthehet në potencial prodhues për eksportin e koncentratit të frutave dhe mollës në vecanti.
- ✓ Manaxhimi i humbjeve në aktivitetin e pentarisë nëpërmjet investimeve në rrjetat antibreshër është një domosdoshmëri absolute. Rreth 1000 ha dëmtohen çdo vit nga fatkeqësitë natyrore.

Kontakte:

Adela Leka, Drejtuese e Projektit AASF: adela.leka@aasf.com.al

Ilir Pilku, Ekspert i Lartë i Agrobiznesit pranë AASF: ilir.pilku@aasf.com.al

Për më shumë informacion: <http://www.aasf.com.al>